UDHËZIM
Nr. 7, datë 20.9.2012

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 618, DATË 7.9.2006 "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR", TË NDRYSHUAR

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, në zbatim të pikës 27 të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006 "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar", të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 7.9.2006, është 9 500 (nëntë mijë e pesëqind) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 1 të vendimit. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i personit me aftësi të kufizuar.
2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 7.9.2006, është 9 500 (nëntë mijë e pesëqind) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2 të vendimit dhe 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj për kujdestari.
3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2012 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2012 për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në programin "Mbrojtja sociale", tit. 10430, kap. 1, art.606.
4. Udhëzimi nr. 114, datë 4.8.2011 i Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet nga 1.9.2012.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera